

**Komisioni evropian
kundër racizmit dhe intolerancës**

**Raporti i tretë për
Shqipërinë**

Miratuar më 17 dhjetor 2004

Strasbourg, 14 qershor 2005



Për informacione plotësuese lidhur me punimet e Komisionit evropian kundër racizmit dhe intolerancës (ECRI) dhe për veprimtari të tjera të Këshillit të Evropës në këtë fushë, lutemi drejtohuni në :

Secretariat of ECRI
Directorate General of Human Rights – DG II
Council of Europe
F - 67075 STRASBOURG Cedex
Tel.: +33 (0) 3 88 41 29 64
Fax: +33 (0) 3 88 41 39 87
E-mail: combat.racism@coe.int

Vizitoni rrjetin tonë web : www.coe.int/ecri

TABELA E LËNDËS

HYRJE	5
PËRMBLEDHJE	6
I. MONITORIMI I RAPORTIT TË DYTË TË ECRI-T PËR SHQIPËRINË	7
INSTRUMENTAT JURIDIKË NDËRKOMBËTARË	7
DISPOZITA KUSHTETUESE DHE DISPOZITA TË TJERA THEMELORE	8
DISPOZITA NË FUSHËN E SË DREJTËS PENALE	8
DISPOZITA NË FUSHËN E SË DREJTËS CIVILE DHE ADMINISTRATIVE.....	9
ADMINISTRIMI I DREJTËSISË	10
ORGANET E SPECIALIZUARA DHE INSTITUCIONET E TJERA	10
- Komiteti kombëtar i posaçëm për minoritetet.....	11
PRITJA DHE STATUTSI I SHQIPTARË	12
- Refugjatët dhe azil-kërkuesit	12
- Migrantët në një situatë ilegale.....	13
EDUKIMI DHE NDËRGJEGJËSIMI.....	14
REGJISTRIMI NË GJENDJEN CIVILE	15
STREHIMI	16
PËRFSHIRJA NË EDUKIM.....	16
- Pjesëmarrja e fëmijëve romë dhe egjyptianë.....	16
- Mësimi në gjuhët minoritare	18
MEDIA	19
QËNDRIMI I PËRFAQËSUESVE TË LIGJIT	20
MONITORIMI I SITUATËS	21
II. ÇËSHTJE TË VEÇANTA	22
MËNJANIMI DHE PAKUJDESIA NDAJ ROMËVE DHE EGJYPTIANËVE	22
PJESËMARRJA E MINORITETEVE NË JETËN PUBLIKE.....	24
- Pjesëmarrja në marrjen e vendimeve politike	24
- Përfaqësimi në institucionet publike	24
- Konsultimi dhe pjesëmarrja e anëtarëve të grupeve minoritare	25
- Zbatimi i Strategjisë kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së romëve	26
TRAFIKU I FËMIJËVE ROMË DHE EGJYPTIANË.....	27
DISKRIMINIM BAZUAR MBI IDENTITETIN EGJYPTIAN.....	29
BIBLIOGRAFI	31

Hyrje

Komisioni evropian kundër racizmit dhe intolerancës (ECRI), ngritur nga Këshilli i Evropës, është një instancë e pavarur monitorimi në fushën e të drejtave të njeriut. I specializuar në çështje të luftës kundër racizmit dhe intolerancës, ai përbëhet nga anëtarë të pavarur e të paanshëm, që janë zgjedhur në bazë të autoritetit të tyre moral dhe të përvojës së tyre të njohur në trajtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me racizmin, ksenofobinë, antisemitizmin dhe intolerancën.

Një nga drejtimet e programit të veprimtarive të ECRI-t është analiza që ai bën vend për vend lidhur me gjendjen e racizmit dhe intolerancës në secilin nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, analizë që çon në parashtrimin e sugjerimeve dhe propozimeve për trajtimin e problemeve që ngrihen.

Trajtimi vend për vend realizohet në tërësinë e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës në barazi të plotë. Punimet kryen në bazë ciklesh prej katër/pesë vjetësh, ku përfshihen nëntë/dhjetë vende në vit. Raportet e ciklit të parë u përfunduan në mbarim të vitit 1998 dhe ato të ciklit të dytë në mbarim të vitit 2002. Punimet e ciklit të tretë filluan në janar 2003.

Raportet vend për vend të ciklit të tretë kanë për bosht « zbatimin » e rekomandimeve kryesore të ECRI-t të përfshira në raportet e mëparshme të tij. Ato shqyrtojnë nga afër në janë ndjekur apo zbatuar këto rekomandime dhe, nëse po, me çfarë efektshmërie. Raportet e ciklit të tretë trajtojnë gjithashtu « çështje të veçanta » zgjedhur në funksion të gjendjes në secilin vend dhe shqyrtuar në mënyrë më të thelluar në secilin raport.

Metodat e punës për përpunimin e raporteve përfshijnë analiza dokumentesh, një vizitë pune në vendin konkret, dhe më pas një dialog konfidencial me autoritetet kombëtare.

Raportet e ECRI-t nuk janë rezultat anketimesh apo thjesht dëshmish, por rezultat analizash, bazuar mbi një numër të madh informacionesh nga burime të larmishme. Studimet në bazë të dokumentave mbështeten në një numër të madh burimesh të shkruara, kombëtare e ndërkombëtare. Vizita në vend bën të mundur takimin me qarqet drejtpërdrejt të interesuara (qeveritare dhe jo qeveritare) dhe mbledhjen e informacioneve të hollësishme. Dialogu konfidencial me autoritetet kombëtare u lejon këtyre të fundit të propozojnë, nëse e shohin të nevojshme, ndryshime në projekt-raport, për të korrigjuar gabime të mundshme faktike të përfshira në tekst. Në përfundim të këtij dialogu, autoritetet kombëtare mund të kërkojnë, nëse dëshirojnë, që mendimet e tyre të paraqiten si shtojcë e raportit përfundimtar të ECRI-t.

Raporti që vijon është përpunuar nga ECRI nën përgjegjësinë e tij të vetme dhe të plotë. Ai paraqet gjendjen deri në datën 17 dhjetor 2004. Zhvillimet që kanë ndodhur pas kësaj date, rrjedhimisht nuk përfshihen në analizën që pason, as nuk merren parasysh në konkluzionet dhe propozimet që parashtrohen.

Përmbledhje

Që nga koha e botimit të raportit të dytë të ECRI-t për Shqipërinë më 3 prill 2001, janë shënuar përparime në mjaft fusha, që vihen në dukje në këtë raport. U përpunua një « Strategji kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së romëve » për të zhdukur diskriminimin ndaj romëve në fusha të ndryshme të jetës. U krijua një komitet kombëtar i posaçëm për minoritetet, me qëllim që t'i paraqiten qeverisë rekomandime lidhur me zhvillimin e të drejtave të minoriteteve. Për më tepër, u vendos një procedurë shqyrtimi paraprak për të përcaktuar statusin e personave jo shtetas shqiptare në gjendje të paligjshme, që merren në pyetje në vend, dhe për të patur kujdes që viktimat e trafikut të qenieve njerëzore, azil-kërkuesit dhe personat që duan të riatdhesohen të trajtohen në mënyrën më të përshtatshme, sipas gjendjes në të cilën ndodhen. U miratua gjithashtu një strategji kombëtare e luftës kundër trafikut të qenieve njerëzore. Përveç kësaj, në të gjitha nivelet, policisë iu bë një formim i nevojshëm lidhur me të drejtat e njeriut.

Megjithatë, Një numër rekomandimesh të parashtruara në raportin e dytë të ECRI-t nuk janë zbatuar, ose janë zbatuar në mënyrë jo të plotë. Në veçanti, ECRI është i shqetësuar për përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e personave që i përkasin grupeve minoritare në jetën publike, një çështje kjo që përbën shqetësim të veçantë për ECRI-in. Ka patur pak përmirësimeve të dukshme të gjendjes së romëve dhe të egjyptianëve, që janë marginalizuar e braktisur në mënyrë të veçantë në shoqërinë shqiptare, Pas debatesh lidhur me identitetin e tyre, egjyptianët gjithashtu e shohin veten objekt masash diskriminuese përse i përket mundësive për të tërhequr vëmendjen e autoriteteve mbi problemet dhe shqetësimet e tyre specifike. Numri disproporcional i fëmijëve romë e egjyptianë i raportuar si viktimat e trafikimit është gjithashtu një problem që preokupon në mënyrë të veçantë ECRI-n. Për më tepër, ECRI vëren se nuk është kryer ende një regjistrim kombëtar që të përmbajë të dhëna lidhur me përkatësinë kombëtare, etnike e fetare. Ai shtron po ashtu një numër çështjesh përse i përket kuadrit ligjor për të luftuar diskriminimin, arsimimit në gjuhët minoritare, regjistrimit në gjendjen civile dhe strehimit.

Në këtë raport, ECRI u rekomandon autoriteteve shqiptare të marrin masa të tjera në disa fusha. Ai këshillon konkretisht një seri të tërë masash për të përmirësuar pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e anëtarëve të disa grupeve minoritare në organet vendimmarrëse dhe në proceset politike, në nivel kombëtar e vendor. ECRI rekomandon të merren masa për të garantuar një integritet të plotë e tërësor të romëve dhe egjyptianëve në jetën shoqërore, ekonomike e politike, në të tëra nivelet, dhe u rekomandon fuqimisht autoriteteve të marrin masa të mëtejshme për të luftuar trafikimin e fëmijëve romë dhe egjyptianë. Gjithashtu, u rekomandon autoriteteve të përkujdesen që romët të marrin pjesë sistematikisht në tërë drejtimit e zbatimit dhe të vlerësimit të « Strategjisë kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së romëve » në nivel kombëtar e vendor dhe që egjyptianët të mos jenë objekt diskriminimi lidhur me pjesëmarrjen dhe përfshirjen e tyre në institucionet publike. Përveç kësaj, ECRI u rekomandon autoriteteve të parashikojnë hartimin e një Strategjie kombëtare të veçantë për përmirësimin e gjendjes së egjyptianëve në Shqipëri. ECRI rekomandon gjithashtu, mbledhjen e të dhënave për të studiuar gjendjen e grupeve të ndryshme minoritare në vend. Veç kësaj, u rekomandon autoriteteve të marrin masa të reja për të shqyrtuar më nga afër ankesat lidhur me keqtrajtimet nga ana e policisë dhe për të garantuar pa ndërprerje të drejtat e azil-kërkuesve dhe migrantëve.

I. MONITORIMI I RAPORTIT TË DYTË TË ECRI-T PËR SHQIPËRINË

Instrumentat juridikë ndërkombëtarë

1. Në raportin e tij të dytë, ECRI i rekomandonte Shqipërisë të bënte një deklaratë në bazë të nenit 14 të Konventës për zhdukjen e të gjitha formave të diskriminimit racial, me qëllim që persona dhe grupe personash të mund t'i paraqesin peticione Komitetit për zhdukjen e diskriminimit racial. ECRI rekomandonte gjithashtu Shqipërisë të nënshkruante e të ratifikonte instrumentat juridikë ndërkombëtarë të mëposhtëm : Kartën evropiane të gjuhëve rajonale ose të minoritetit Konventën evropiane lidhur me statusin juridik të punonjësit migrues dhe Konventën evropiane për pjesëmarrjen e të huajve në jetën publike në nivel lokal. Përveç kësaj ECRI i rekomandonte Shqipërisë të ratifikonte Kartën sociale evropiane të rishikuar dhe Konventën evropiane mbi shtetësinë.
2. ECRI vëren me kënaqësi se Shqipëria ka nënshkruar Konventën evropiane për pjesëmarrjen e të huajve në jetën publike në nivel vendor. Është njoftuar po ashtu nga autoritetet shqiptare që Këshilli i Ministrave të Shqipërisë ka miratuar një projektligj për ratifikimin e kësaj Konvente, e cila i është dhënë Kuvendit të Shqipërisë për miratim përfundimtar.
3. ECRI vëren me kënaqësi po ashtu se Shqipëria ka ratifikuar Kartën sociale evropiane të rishikuar dhe Konventën evropiane mbi shtetësinë. Autoritetet shqiptare e kanë njoftuar se është në vazhdim e sipër një procedurë lidhur me deklaratën e parashikuar nga neni 14 i Konventës për zhdukjen e të gjitha formave të diskriminimit racial.
4. Shqipëria nuk ka nënshkruar ende Kartën evropiane të gjuhëve rajonale ose të minoritetit, Konventën evropiane lidhur me statusin juridik të punonjësit migrues apo Konventën ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të punonjësve migrues dhe të anëtarëve të familjeve të tyre. Autoritetet shqiptare e kanë njoftuar ECRI-n se Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale është duke përgatitur një raport vlerësues lidhur me anëtarësimin e vendit në Konventën ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të punonjësve migrues dhe të anëtarëve të familjeve të tyre dhe synon ta përfundojë procedurën e anëtarësimit deri në fund të vitit 2006.
5. ECRI shpreh kënaqësinë për faktin se më (data e miratimit të ligjit për ratifikimin e këtij protokoli është 29 korrik 2004) 26 nëntor 2004 Shqipëria ratifikoi Protokollin n° 12 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut (CEDH) dhe Protokollin shtesë të Konventës për krimin kibernetik për penalizimin e akteve raciste e ksenofobe të kryera nëpërmjet sistemeve kompjuterike.

Rekomandime :

6. ECRI u rekomandon autoriteteve shqiptare të përfundojnë sa më shpejt procesin e ratifikimit të Konventës evropiane për pjesëmarrjen e të huajve në jetën publike në nivel lokal. Ai u rekomandon po ashtu të bëjnë një deklaratë në bazë të nenit 14 të Konventës për zhdukjen e të gjitha formave të diskriminimit racial dhe për nënshkrimin e Kartës evropiane të gjuhëve rajonale ose të minoritetit, Konventës evropiane lidhur me statusin e punonjësve migrant dhe Konventës së Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punonjësve migrant.

Dispozita kushtetuese dhe dispozita të tjera themelore

7. Kushtetuta shqiptare garanton parimin e përgjithshëm të barazisë para ligjit dhe i mbron shtetasit nga diskriminimit bazuar në motive të tilla si raca, origjina etnike, gjuha, besimi, statusi shoqëror ose prejardhja. Ajo ndalon gjithashtu organizatat që nxisin dhe mbështesin urrejtjen raciale, fetare, krahinore ose etnike. Nga ana tjetër, ajo parashikon një kuadër të gjerë për mbrojtjen dhe zhvillimin e identitetit të minoriteteve kombëtare dhe dhënien e të drejtës së tyre në këtë fushë, ashtu sikurse dhe për personat jo shtetas shqiptarë dhe personave të tjerë pa shtetësi, që janë të pranishëm në territorin shqiptar, të drejta, liri dhe detyra që i parashikon, për aq sa dispozita të veçanta nuk kufizojnë shprehimisht zbatimin e tyre vetëm për shtetasit shqiptarë. Në raportin e tij të dytë, ECRI i nxiste autoritetet shqiptare që këto dispozita të pasqyroheshin në legjislacion dhe të gjenin me të vërtetë zbatim.
8. Nuk ekziston pothuaj asnjë e drejtë e prejdardhur për zbatimin me të vërtetë të këtyre parimeve të gjera kushtetuese. ECRI është njoftuar nga autoritetet se parimet kushtetuese janë drejtpërdrejt të zbatueshme ; nuk ekziston megjithatë asnjë shembull zbatimi të këtyre neneve.

Rekomandime :

9. ECRI u rekomandon autoriteteve shqiptare të miratojnë legjislacionin e nevojshëm të prejdardhur, që të sigurojë zbatimin në praktikë të garancive kushtetuese lidhur me racizmin, barazinë dhe mosdiskriminimin. ECRI rekomandon gjithashtu të ndërmaren nisma për të sensibilizuar publikun dhe juristët përi mundësitë për të shprehur drejtpërdrejt këto garanci kushtetuese.

Dispozita në fushën e së drejtës penale

10. Në raportin e tij të dytë për Shqipërinë, ECRI rekomandonte të parashikohej shprehimisht që gjykatat t'i konsiderojnë motivet raciste si faktor rëndues dhe të përkufizohen shkeljet me motiv racist si shkelje të veçanta. ECRI vëren se autoritetet shqiptare e kanë parasysh futjen e një dispozite në këtë drejtim.
11. Që prej raportit të dytë të ECRI-t, kjo çështje ka qenë objekt shqyrtimi më nga afër, por qeveria ende nuk ka paraqitur projektligj. Autoritetet shqiptare e kanë vënë ECRI-n në dijeni se cilësimi i shkeljeve me karakter racist si shkelje të veçanta do të shtronte probleme në sistemin juridik shqiptar dhe se do të ishte më e natyrshme të konsiderohej motivi racist si faktor rëndues. Autoritetet kanë theksuar se kanë ndër mend të kryejnë ndryshimet legjislative të domosdoshme brenda vitit 2005.

Rekomandime :

12. ECRI u rekomandon përsëri autoriteteve shqiptare të parashikojnë shprehimisht në ligjin penal që motivi racist të përbëjë një rrethanë rënduesëe veçantë për të gjitha veprat penale.

13. Në raportin e tij të dytë për Shqipërinë, ECRI i nxiste autoritetet shqiptare të vazhdonin përpjekjet e tyre me qëllim që legjislacioni lidhur me racizmin, diskriminimin dhe intolerancën të zbatohet sistematikisht në tërë nivelet e sistemit të zbatimit të ligjit. Në këtë drejtim, ai vinte në dukje se ishte e rëndësishme që pushteti gjyqësor të ishte i formuar sa më mirë e i pavarur, dhe që forcat e policisë të ndërjegjësoheshin për çështjet e racizmit e të diskriminimit.
14. Autoritetet shqiptare zbatojnë një seri masash për të përmirësuar funksionimin e sistemit gjyqësor. Autoritetet shqiptare kanë vënë gjithashtu në dijeni ECRI-n se një formim i konsoliduar, ku përfshihej një formim lidhur me çështjet e racizmit, diskriminimit dhe intolerancës ishte arritur me oficerët e policisë gjyqësore, me prokurorët dhe gjykatësit. Megjithatë, mbeten ende probleme që kanë të bëjnë me zbatimin e legjislacionit penal në fushën e racizmit dhe diskriminimit, sikurse me atë të legjislacionit penal në mënyrë më të përgjithshme. Më 2002 dhe 2003, vetëm pesë vetë në total janë dënuar në bazë të nenit 265 (nxitje për urrejtje kombëtare, raciale ose fetare). Asnjë informacion plotësues nuk është dhënë nga autoritetet shqiptare për zbatimin e dispozitave të tjera përkatëse të së drejtës penale, sikurse neni 266 (cënim i rendit publik nëpërmjet nxitjes së urrejtjes ndaj disa grupeve të popullsisë) dhe neni 253 (dallime të disfavorshme bërë nga një nëpunës shtetëror apo nga një shërbim publik mbi bazën e një serie motivesh, ndër të cilat përkatësia etnike, kombëtare, racore apo fetare).
15. Është e njohur gjerësisht se korrupsioni vazhdon të mbajë lidhur sistemin gjyqësor dhe organet e tjera të zbatimit të ligjit. Autoritetet shqiptare e pranojnë këtë problem dhe kanë vënë në dijeni ECRI-n se po marrin masa për të luftuar kundër korrupsionit dhe qëndrimeve të dënueshme.

Rekomandime :

16. ECRI u rekomandon përsëri autoriteteve shqiptare të marrin masat e nevojshme për të siguruar zbatimin e dispozitave penale lidhur me racizmin, diskriminimin dhe intolerancën. Përveç masave të përgjithshme që synojnë të përmirësojnë funksionimin e sistemit të drejtësisë penale, ECRI rithekson rëndësinë për t'u dhënë të gjithë atyre që punojnë në sistemin e drejtësisë penale – polici, prokurori dhe gjyqësor – formimin e veçantë lidhur me dispozitat e zbatueshme të legjislacionit kombëtar dhe të sensibilizojnë punonjësit e funksionit publik me problemet e racizmit, diskriminimit dhe intolerancës.
17. ECRI rekomandon gjithashtu të mblidhen të dhëna plotësuese për zbatimin e dispozitave të së ligjit penal në këtë fushë, me qëllim që të vlerësohet efektshmëria e tyre.

Dispozita në fushën e së drejtës civile dhe administrative

18. Në raportin e dytë për Shqipërinë, ECRI vinte në dukje dispozitat që sigurojnë barazinë e të drejtave në disa fusha të jetës, si mbrojtja sociale dhe edukimi. Ai vinte po ashtu në dukje se Kodi i punës (neni 9) garanton mosdiskriminimin, si në sferën publike ashtu dhe në sferën private. Megjithatë, ai u rekomandonte autoriteteve shqiptare të përforconin më shumë kuadrin ligjor në këtë drejtim, duke krijuar një tërësi ligjore për të luftuar diskriminimin në tërë fushat e jetës, dhe konkretisht në strehim, punësim, edukim, përfshirje në sistemin e ndihmave financiare dhe administratë. ECRI theksonte rolin parandalues dhe edukativ që

mund të luaj ky legjislacion, si dhe dobinë e tij për të nxjerrë në dritë praktika diskriminuese.

19. Nuk ka patur zhvillime përsa i përket dispozitave në fushën e së drejtës civile dhe administrative për të luftuar diskriminimin. ECRI u tërheq vëmendjen autoriteteve shqiptare lidhur me Rekomandimin e tij n° 7 të politikës së përgjithshme mbi legjislacionin kombëtar për të luftuar kundër racizmit dhe diskriminimit racial, i cili përfshihen rekomandime të qarta për dispozitat që ECRI mendon se duhet të figurojnë në një tërësi aktesh të së drejtës civile dhe administrative për luftën ndaj diskriminimit racial. ECRI dëshiron të vërë në dukje se rekomandimi i tij mban parasysh që ky legjislacion duhet jo vetëm të zbatohet ndaj diskriminimit të drejtpërdrejtë, por edhe ndaj diskriminimit të tërthortë, dhe parashtron një seri masash për të lehtësuar zbatimin e legjislacionit në këtë fushë, përfshirë dhe ndryshimin e barrës së të provuarit .

Rekomandime

20. ECRI u rekomandon përsëri autoriteteve shqiptare të forcojnë edhe më shumë kuadrin ligjor në këtë fushë, duke hartuar një legjislacion të plotë për luftën kundër diskriminimit të drejtpërdrejtë e të tërthortë në fushat kryesore të jetës. Për këtë qëllim, ai u rekomandon autoriteteve të mbajnë parasysh Rekomandimin e tij n° 7 të politikës së përgjithshme mbi legjislacionin kombëtar për luftën kundër racizmit dhe diskriminimit racial. Ai vë përsëri në dukje rolin edukativ dhe parandalues që ky legjislacion mund të luaj dhe nevojën e tij për të nxjerrë në pah praktika diskriminuese.

Administrimi i drejtësisë

21. Në raportin e tij të dytë, ECRI tërhiqte vëmendjen se problemet lidhur me funksionimin e sistemit gjyqësor pengonin zbatimin e legjislacionit në fushën e racizmit dhe diskriminimit, si dhe në fusha të tjera.
22. Që prej raportit të dytë të ECRI-t, autoritetet shqiptare kanë marrë një seri masash për të përmirësuar funksionimin e sistemit gjyqësor, në veçanti për të luftuar kundër korrupsionit, për të zhvilluar edhe më shumë infrastrukturën e domosdoshme dhe për të zhvilluar një sistem të administrimit të çështjeve. Megjithatë, pavarësisht nga këto masa, funksionimi i sistemit gjyqësor vazhdon të ketë probleme.

Rekomandime :

23. ECRI u rekomandon autoriteteve shqiptare të vazhdojnë e të forcojnë përpjekjet e tyre për të përmirësuar funksionimin e sistemit gjyqësor.

Organet e specializuara dhe institucionet e tjera

24. Në raportin e tij të dytë, duke theksuar rolin e rëndësishëm që mund të luajnë organet e specializuara për t'u ndeshur me problemet e diskriminimit dhe për të nxjerrë në pah forma të fshehta diskriminimi në fusha të ndryshme, ECRI u rekomandonte autoriteteve shqiptare të rrisnin në këtë drejtim kompetencat e Zyrës së posakrijuar të Avokatit të popullit (Ombudsmanit).

25. Që prej raportit të dytë të ECRI-t, Zyra e Avokatit të Popullit funksionon dhe vijon të marrë një numër ankesash në rritje. Më 2003, kjo zyrë vuri në dukje se ka marrë 4.400 ankesa, nga të cilat 25% u zgjidhen pozitivisht në favor të ankuesit. Zyra deklaroi se deri më sot, nuk ka konstatuar asnjë shkelje të të drejtave të njeriut në çështje që kanë të bëjnë me grupet minoritare. Zyrës i është drejtuar një çështje, të cilën ajo e konsideron se përmban elementë diskriminimi, që kanë çuar në vdekjen e një gruaje rome gjatë lindjes. Kjo shifër i duket ECRI-t e vogël, duke patur parasysh indiferentizmin dhe marginalizimin që ai beson se prek bashkësitë rome dhe egjyptiane në fusha të ndryshme.
26. Zyra nuk e ka shqyrtuar çështjen e krijimit të një seksioni të veçantë i fokusuar në problemet e racizmit dhe diskriminimit. Ajo është duke krijuar aktualisht një seksion të ri, që do merret kryesisht me shkeljet e të drejtave të fëmijëve. ECRI është i kënaqur të theksojë çka Zyra i vuri në dukje, se theksi do të vihet në mënyrë të veçantë tek të drejtat e fëmijëve romë. ECRI është i kënaqur të theksojë se Zyra është duke krijuar aktualisht zyra rajonale, me qëllim që të kontaktohet më me lehtësi njerëzit që nuk jetojnë në kryeqytet.

Rekomandime :

27. ECRI i rekomandon Zyrës së Avokatit të Popullit t'i kushtojë vëmendje të veçantë faktit se ankesa për një çështjeje të marrë, mund të përmbajë në vetvete një element diskriminimi, për më tepër që ky element jo gjithnjë i bie në sy menjëherë qoftë edhe viktimës, konkretisht kur është fjala për diskriminim të tërthortë. Për rrjedhojë, do të ishte me vend trajnimi i personelit të Zyrës me shfaqjet e ndryshme të mundshme të racizmit dhe diskriminimit.
28. ECRI i rekomandon nga ana tjetër Zyrës së Avokatit të Popullit të parashikojë të mbajë parasysh origjinën etnike apo kombëtare të ankuesve në kuadrin e veprimtarive të veta të zakonshme, pikërisht sepse këto të dhëna mund të jenë thelbësore për të zbuluar forma diskriminimi të drejtpërdrejta ose të tërthorta.
29. ECRI mbështet Zyrën e Avokatit të Popullit që parashikon t'i kushtojë vëmendje të veçantë të drejtave të fëmijëve romë dhe i rekomandon fuqimisht të jetë në mënyrë të veçantë po aq i vëmendshëm edhe ndaj të drejtave të fëmijëve egjyptianë.
30. ECRI mbështet autoritetet shqiptare që parashikojnë të krijojnë një organi të specializuar në luftën kundër racizmit dhe diskriminimit racial, duke mbajtur parasysh Rekomandimet e tija N° 2 dhe N° 7 të politikës së përgjithshme.

- Komiteti kombëtar i posaçëm për minoritetet

31. ECRI vëren me kënaqësi se më 11 mars 2004, qeveria miratoi krijimin e një komiteti kombëtar të posaçëm për minoritetet. Ky komitet i ri është ngarkuar t'i bëjë rekomandime qeverisë për të çuar më tej të drejtat e minoriteteve në të gjitha fushat e jetës. Ka në përbërje të tij një anëtar nga çdo minoritet, njohur zyrtarisht si minoritet kombëtar, konkretisht minoritetet greke, malazeze e maqedone, dhe një anëtar nga secili prej minoriteteve njohur zyrtarisht si minoritet kulturor/gjuhësor, konkretisht minoritetet arumune/vllehe dhe rome.

ECRI vëren me shqetësim se minoriteti egjiptian nuk mund të marrë pjesë në këtë komitet, ngaqë autoritetet shqiptare nuk e njohin¹.

32. Deri më sot, komiteti funksionon pa sekretariat ose mbështetje tjetër, dhe informacionet që merr ECRI tregojnë se komiteti ka burime financiare minimale. ECRI bën të ditur shqetësimin e tij për mungesën e konsultimeve të mjaftueshme me palët dhe grup-interesat e ndryshme që ndodhen në gjirin e çdo minoriteti, sikurse theksohet në pjesën II të këtij raporti².

Rekomandime :

33. ECRI i rekomandon Komitetit kombëtar të posaçëm për minoritetet të drejtojnë vëmendjen përi çështjet diskriminuese, përfshirë edhe diskriminimin e tërthortë.
34. ECRI u rekomandon autoriteteve shqiptare të bëjnë të mundur që Komiteti kombëtar i posaçëm për minoritetet të ketë burime të nevojshme financiare e njerëzore, me qëllim që të arrihet funksionimi i tij sa më i mirë.

Pritja dhe statutsi i shtetasve jo shqiptarë

- Refugjatët dhe azil-kërkuesit

35. Në raportin e tij të dytë, ECRI i nxiste autoritetet shqiptare të vazhdonin përpjekjet për të krijuar sa më shpejt një sistem azili të efektshëm. Ai u rekomandonte po ashtu të kujdeseshin që rojet kufitare dhe punonjësit që merren me procedurën e azilit të kenë formimin e nevojshëm, konkretisht përsa u përket të drejtave të njeriut dhe legjislacionit përkatës në këtë fushë.
36. Procedura e azilit në Shqipëri është tanimë operative, megjithëse sistemi varet ende në pjesën më të madhe nga Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR) dhe nga OJQ-të që ai mbështet për të marrë përsipër përgjegjësi, të cilat më vonë do t'u takojnë autoriteteve shqiptare. Për shembull, UNHCR-ja jep letërnjoftime me kërkesë të Ministrisë së Rendit, ndërsa një OJF merr jep mbrojtje shëndetësore e sociale, një OJF tjetër jep ndihmë ligjore dhe asistencën për shkollimin e fëmijëve e jep një OJF tjetër.. Qendra e pritjes në Tiranë, ku strehohen azil-kërkuesit, administrohej nga HCR-ja deri në tetor 2004, dhe pas kësaj date, ajo iu besua autoriteteve shqiptare. Legjislacioni kryesor dytësor ende duhet të zhvillohet në këtë drejtim. Kjo pamjaftueshmëri, si dhe mungesa e burimeve financiare përbëjnë vështirësi të mëdha që i pengojnë autoritetet shqiptare të marrin përsipër përgjegjësinë e plotë të procedurës së azilit. Autoritetet shqiptare po marrin aktualisht masa për të zhvilluar legjislacionin e nevojshëm dytësor.
37. ECRI është vënë në dijeni se punonjës të ndryshëm shtetërorë që marrin pjesë në procedurën e azilit, përfshirë edhe policinë kufitare, policinë e rendit publik, dhe punonjës të policisë së specializuar në trafikun e qenieve njerëzore, janë formuar përsa i përket njohjes së procedurave të azilit dhe të drejtave të azil-kërkuesve. Organizatat ndërkombëtare kanë luajtur deri më sot një rol të

¹ Shih më poshtë "Diskriminim bazuar mbi identitetin egjiptian".

² Shih më poshtë "Pjesëmarrja e minoriteteve në jetën publike", "Konsultimi dhe angazhimi i minoriteteve".

rëndësishëm në këto nisma formimi. Ky formim është pjesë e kursve të kualifikimit në akademin e policisë.

Rekomandime :

38. ECRI u rekomandon autoriteteve shqiptare të vazhdojnë të miratojnë legjislacionin e domosdoshëm dytësor dhe të përcaktojnë masat e tjera të nevojshme për të marrë tërësisht përsipër përgjegjësinë e procedurës së azilit.
39. ECRI nxit autoritetet shqiptare të përkujdesen që, në kuadrin e formimit fillestar e të vazhdueshëm, punonjësit shtetërorë kompetentë të vazhdojnë të marrin formimin e duhur për procedurën e azilit dhe për të drejtat e azil-kërkuesve.

- Migrantët në një situatë ilegale

40. Në raportin e tij të dytë, ECRI u rekomandonte autoriteteve shqiptare të bënin të mundur që kategoritë e ndryshme të imigrantëve – imigrantë ekonomikë, azil-kërkues dhe gratë- viktima të trafikut të qenieve njerëzore për qëllime prostitucioni – të mos trajtoheshin në të njëjtën mënyrë. Në këtë drejtim, ai i nxiste autoritetet shqiptare të bënin të mundur që personat që kapeshin në mënyrë ilegale në Shqipëri të mos trajtohen si kriminelë.
41. ECRI vëren me kënaqësi se më 2001, u vendos një procedurë shqyrtimi paraprak për të përcaktuar statusin e të huajve të kapur në vend në mënyrë ilegale. Sipas kësaj procedure, zbatuar si nga Ministria e Rendit Publik, ashtu dhe nga mjaft organizata ndërkombëtare, kur një nëj shtetas shqiptarë kapet në mënyrë ilegale në vend çështja i kalohet një ekipi, i cili hyn në bashkëbisedim paraprak me këtë të fundit për të bërë një vlerësim të parë të gjendjes së tij. Personat viktimë të trafikut të qenieve njerëzore, azil-kërkuesit dhe personat që dëshirojnë të riatdhesohen trajtohen sipas gjendjes në të cilën ndodhen. Autoritetet shqiptare kanë njoftuar ECRI-n se nuk kanë munguar nismat për të siguruar formimin me normat ndërkombëtare të nevojshme të funksionarëve shqiptarë në kontakt me migrantët. Nga ana tjetër, sipas informacioneve që ECRI ka marrë nga autoritetet shqiptare dhe nga UNHCR, dispozitat e Kodit penal që ndëshkojnë kalimin e paligjshëm të kufirit të një shteti nuk janë zbatuar.
42. UNHCR ka njoftuar ECRI-n se procedura e shqyrtimit paraprak aktualisht zbatohet për shtetasit jo shqiptarë të ndaluar në Shqipëri, dhe se shtrirja e programit është parashikuar gjithashtu edhe për zonat kufitare. Sipas shifrave të policisë, në 2003, gjashtëdhjetë e nëntë personave të shtetësive të ndryshme u është refuzuar hyrja në vend në pikat kufitare. ECRI-t i është bërë e ditur se, ngaqë mungojnë policë me formimin e duhur, ngaqë nuk gjenden në kohë përkthyes të kualifikuar dhe infrastrukturat ekzistuese lënë për të dëshiruar, është pothuaj e pamundur për një person që ka nevojë për mbrojtje ndërkombëtare të futet në sistemin e azilit në kufi ose në « zonat neutrale » në kufi, gjë që mund të sjellë si rezultat prapësimin e tij. Pavarësisht nga qendrat ekzistuese, viktimat e trafikut të qenieve njerëzore nuk përfitojnë asistencën e nevojshme.

Rekomandime :

43. ECRI u rekomandon autoriteteve shqiptare të vazhdojnë të bëjnë të mundur që shtetasit jo shqiptarë që gjendet në Shqipëri në mënyrë ilegale të mos trajtohen si kriminelë.
44. ECRI rekomandon fuqimisht të respektohet parimi i mossprapjes dhe t'u sigurohet mundësi hyrjeje personave që kanë nevojë për mbrojtje dhe asistencë ndërkombëtare. Në këtë drejtim, ai u rekomandon autoriteteve shqiptare të shtrijnë sa më parë procedurën e shqyrtimit paraprak në zonat kufitare dhe në « zonat neutrale » në kufi.

Edukimi dhe ndërgjegjësimi

45. Në raportin e tij të dytë për Shqipërinë, ECRI u rekomandonte autoriteteve shqiptare të përfshinin në programet shkollore, në të tëra nivelet, çështjet që kanë të bëjnë me tolerancën, me respektimin e dallimit dhe me kontributet që japin minoritetet etnike në shoqëri, si dhe të përkujdeseshin që arsimtarët të merrnin formim në këtë drejtim. Ai vinte po ashtu në dukje se ishte e rëndësishme që historia të mësohej në mënyrë të tillë që të nxitej vlerësimi i larmisë kulturore.
46. Autoritetet shqiptare e kanë njoftuar ECRI-n se janë duke përpunuar aktualisht programe dhe tekste të reja shkollore për të nëntë nivelet e arsimit të detyrueshëm, dhe se kanë parasysh të përfshijnë në to informacione lidhur me kulturën dhe historinë e minoriteteve të ndryshme në Shqipëri. Ato e kanë njoftuar po ashtu se edukimi qytetar është pjesë e planit pedagogjik për tërë institucionet shkollore. Përsa i përket mësimin të historisë, autoritetet shqiptare e kanë vënë ECRI-n në dijeni se një udhëzim i dhënë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës u kërkon pedagogëve që shpjegojnë pozitën e shteteve rajonale dhe shteteve fqinje të Shqipërisë, t'u përcjellin nxënësve një mesazh mirëkuptimi, harmonie, tolerance dhe bashkëpunimi në marrëdhëniet midis vendeve dhe kombeve të rajonit. Autoritetet shqiptare kanë theksuar se ky mesazh do të përfshihet në tekstet që janë duke u përpunuar. Megjithatë, përfaqësues nga minoriteti grek e kanë njoftuar ECRI-n se tekstet ekzistuese të historisë përmbanin për mendimin e tyre, referenca shoviniste për grekët. Një komision ndërqeveritar i përbashkët po punon për këtë çështje.

Rekomandime :

47. ECRI mbështet autoritetet shqiptare në përpjekjet që bëjnë për rishikimin e programeve shkollore ; ai rekomandon përsëri të programe shkollore, në të gjitha nivelet, të përfshihen materiale që kanë të bëjnë me tolerancën, respektimin e dallimit dhe kontributet që japin minoritetet etnike në shoqëri. Mësuesit gjithashtu duhet të përfitojnë formim të nevojshëm në këtë drejtim.
48. ECRI u rekomandon po ashtu autoriteteve të përkujdesen që materialet pedagogjike, konkretisht tekstet e historisë, të mos nxitin stereotipe negative ose mostolerance ndaj ndonjë bashkësie etnike, cilado qoftë ajo, por të zhvillojnë në të kundërt vlerësimin e larmisë kulturore. Për më tepër, ECRI rekomandon që përfaqësuesit e bashkësive të ndryshme etnike të marrin pjesë në këtë proces.

Regjistrimi në gjendjen civile

49. ECRI shpreh shqetësimin e tij përpara numrit disproporcional të fëmijëve romë dhe egjiptianë që nuk janë regjistruar në gjendjen civile. Ky problem ka pasojë negative për të drejtat e tyre në mjaft sektorë të jetës, si përfshirja në shërbime të ndryshme, konkretisht edukim, shërbime sociale dhe përkujdesje shëndetësore, si dhe përsa i përket mundësisë për të gëzuar të drejtat qytetare, sikurse e drejta e votimit. Sipas legjislacionit shqiptar, të gjithë qytetarët gëzojnë të drejtën dhe detyrimin të regjistrojnë fëmijët në regjistrin e gjendjes civile dyzet e pesë ditë pas lindjes. Për këtë qëllim, prindërit duhet të paraqesin një seri dokumentesh, si : çertifikatë lindjeje të fëmijës apo dëshmi të lindjes së tij ; dhe çertifikatat e tyre të lindjes në rastet kur prindërit nuk janë ligjërisht të martuar. Kur kalon afati prej dyzet e pesë ditësh, duhet nisur procedura gjyqësore për regjistrimin e fëmijës dhe jepet gjobë për regjistrim të vonuar.
50. Nëse kriteret dhe procedurat janë të njëjta për të gjithë, në praktikë, ato diskriminojnë tërthorazi bashkësitë rome dhe egjiptiane, përderisa arrijnë të përjashtojnë një numër të disproporcional fëmijësh romë dhe egjiptianë. Sipas burimeve të ndryshme nga shoqëria civile, problemet shkaktohen pjesërisht për faktin se prindër romë dhe egjiptianë nuk e dinë që duhet të deklarojnë fëmijët e tyre brenda dyzet e pesë ditëve pas lindjes. Por prapë, edhe kur prindërit e dinë një gjë të tillë, shpesh e kanë të vështirë të paraqesin dokumentet e nevojshme. Organizata rome e kanë informuar ECRI-n se një tjetër problem qëndron për faktin që romët priren të martohen dhe të kenë fëmijë para moshës ligjore dhe, në këtë mënyrë, s'ka si të mendojnë se duhet të deklarojnë fëmijën e tyre. Me të kaluar afati i dyzet e pesë ditëve, shpenzimet për gjyq dhe problemet që parashtron funksionimi i sistemit gjyqësor bëhen pengesë për shumicën e romëve dhe egjiptianëve.
51. ECRI i sheh me kënaqësi disa nisma që synojnë të regjistrojnë në gjendjen civile fëmijët romë, sikurse ato të ndërmarra nga bashkia e Tiranës. Në këto nisma përfshihen aksione ndërgjegjësimit për procesin e regjistrimit, duke iu drejtuar drejtpërdrejt bashkësive rome, si dhe masat për të listuar fëmijët romë që nuk janë regjistruar dhe për të lehtësuar kështu regjistrimin e tyre të drejtpërdrejtë në zyrën e gjendjes civile, qoftë edhe kur ka përfunduar afati prej dyzet e pesë ditësh. Nisma të tjera pozitive synojnë heqjen nga autoritetet shqiptare të shpenzimeve që lidhen me regjistrimin, deri më 28 shkurt 2005.

Rekomandime :

52. ECRI u rekomandon fuqimisht autoriteteve shqiptare të marrin masa që të gjithë fëmijët romë dhe egjiptianë të regjistrohen në gjendjen civile. Mund të përcaktohen në këtë rast masa pozitive, si fushatat e ndërgjegjësimit dhe zgjatja e afatit prej dyzet e pesë ditësh parashikuar për regjistrim, po ashtu edhe zgjatja e periudhës së heqjes së shpenzimeve për regjistrim, ose masa të tjera të ngjashme që lehtësojnë regjistrimin.

Strehimi

53. Përveç kushteve të këqija të jetesës dhe pamjaftueshmërisë së infrastrukturave, për të cilat bëhet fjalë më poshtë³, përfaqësues romë dhe egjyptianë i kanë deklaruar ECRI-t se anëtarë të bashkësive të tyre ishin viktime të diskriminimeve përsa i përket dëbimit të tyre nga terrene që kishin pushtuar në mënyrë të paligjshme. Që prej demokratizimit të Shqipërisë, shumë persona zaptojnë terrene pa të drejtë pronësie dhe ndërtojnë në to shtëpitë e tyre. Autoritetet shqiptare përpiqen aktualisht të përballen me këtë problem, konkretisht duke miratuar ligjin n° 9304 « Mbi legalizimin dhe urbanizimin e zonave të paligjshme ». Megjithatë, sipas disa çështjeve, në Tiranë në mënyrë të veçantë, autoritetet kanë prishur banesa të tilla duke dëbuar të strehuarit në to. Bashkia e këtij qyteti e vuri në dijeni ECRI-n se ajo vepronte në këtë mënyrë kur terreni ishte i domosdoshëm për punime të interesit publik. Ata gjithashtu deklarojnë se nuk asnjë diskriminim dhe se të gjithë njerëzit trajtohen në mënyrë të barabartë, cilado qoftë origjina e tyre etnike. Nga ana tjetër, përfaqësues romë dhe egjyptianë, e kanë vënë ECRI-n në dijeni për raste të vërejtura kryesisht në Tiranë, kur anëtarë të bashkësive të tyre janë dëbuar nga strehimet ku jetonin prej shumë vitesh, pa mundur të ristrehohen apo pa përfituar kredi për banesë, siç kanë përfituar bashkëqytetarë të tyre të ndodhur në të njëjtat kushte. Ata, pra, janë të pastrehë.
54. Autoritetet shqiptare e kanë vënë në dijeni ECRI-n se një ligj i ri « Mbi programet e strehimit shoqëror » ka hyrë në fuqi në dhjetor 2004. Është ngritur një komitet kombëtar për strehimin, që do të përgjigjet për zbatimin e këtij ligji. Për më tepër, është krijuar një fond buxhetor për të parashikuar strehim për tërë kategoritë e njerëzve të konsideruar si të pastrehë.

Rekomandime :

55. ECRI u rekomandon autoriteteve shqiptare të kenë parasysh që romët dhe egjyptianët e dëbuar nga banesat e tyre të gëzojnë të njëjtat mundësi ristrehimi dhe të përfitojnë kredi banese, ashtu si dhe qytetarët e tjerë shqiptarë. ECRI u rekomandon po ashtu që çdo dëshmi diskriminimi gjatë një dëbimi të studjohet në mënyrë të thelluar.
56. ECRI mbështet autoritetet në përpjekjet që bëjnë për të rregulluar gjendjet e paligjshme në fushën e strehimit dhe për të ndihmuar personat pa strehë, duke u rekomanduar të bëjnë të mundur që bashkësitë romë dhe egjyptiane të përfitojnë plotësisht nga nisma të tilla.

Përfshirja në edukim

- Pjesëmarrja e fëmijëve romë dhe egjyptianë

57. Në raportin e tij të dytë, ECRI i nxiste autoritetet shqiptare të bënin një përpjekje të veçantë për t'i bërë ballë përqindjes së lartë të braktisjes së shkollës nga ana e fëmijëve romë e egjyptianë dhe për të rritur pjesëmarrjen e anëtarëve të këtyre grupeve në të gjitha nivelet e sistemit edukativ. Në këtë drejtim, ai sugjeronte gjithashtu të studjohej se deri në ç'skallë mund të ndikonin paragjykimet dhe

³ Shih pjesën II, Probleme të veçanta, "mënjanimi i romëve dhe egjyptianëve".

stereotipet e arsimtarëve lidhur me pjesëmarrjen e këtyre fëmijëve në shkollë. Ai rekomandonte nga ana tjetër t'u propozojë arsimtarëve një stazh formimi për të njohur konkretisht nevojat dhe dëshirat e veçanta të fëmijëve romë dhe egjiptianë, duke u shpjeguar si t'i ndihmojnë dhe nxisin fëmijët e këtyre bashkësive për të marrë pjesë plotësisht në sistemin shkollor.

58. ECRI vëren me shqetësim se frekuentimi i dobët dhe braktisja shkollore nga ana e fëmijëve romë dhe egjiptianë mbetet një problem më vete. Organizata të shoqërisë civile kanë nxjerrë në pah, ndër faktorët kryesorë që ndikojnë, varfërinë e familjeve, që kanë nevojë për fëmijët e tyre për t'u sjellë një të ardhur, si dhe shpenzimet lidhur me shkollimin (tekste, pajisje shkollore, veshje, etj.). Organizata romë kanë ngritur gjithashtu probleme që kanë të bëjnë me regjistrimin në gjendjen civile dhe mungesën e certifikatave të lindjes. Për më tepër, në disa zona është gjithashtu problem fakti që fëmijët romë që shkojnë në shkollë nuk kanë njohuri të mirë të shqipes. Organizata romë kanë vërejtur po ashtu se është nga ana tjetër e rëndësishme të mësohet gjuha e tyre si gjuhë e dytë në bashkësitë ku jetojnë romë, duke qenë se një gjë e tillë mund të ketë ndikim pozitiv në rezultatet shkollore. Për më tepër, ECRI vë në dukje edhe një herë rolin që mund të luajnë faktorë të tillë si paragjykimet dhe stereotipet e arsimtarëve dhe tekstet shkollore, që paraqesin një pamje negative për romët dhe egjiptianët, pa mbajtur parasysh kulturën e tyre dhe kontributin që i japin shoqërisë.
59. Autoritetet shqiptare, që janë të ndërgjegjshme për frekuentimin e dobët dhe përqindjen e lartë të braktisjes së shkollës nga ana e fëmijëve të këtyre bashkësive, i kanë bërë të ditur ECRI-t se do t'i zgjidhin këto probleme. Përmirësimi i përfshirjes së fëmijëve romë në edukim është objektiv i « Strategjisë për përmirësimin e kushteve jetësore të romëve ». Autoritetet e kanë njoftuar ECRI-n se janë ndërmarrë shumë nisma në kuadrin e kësaj strategjie, përfshirë edhe studime të ministrisë së Arsimit për të mbledhur të dhëna mbi gjendjen e romëve në fushën e edukimit, projekte që kanë për objektiv mësimin nga arsimtarë romë të gjuhës romani në shkollat fillore; ndërtimin e shkollave në përqëndrime të mëdha fëmijësh romë; ndërgjegjësimin e prindërve romë për të nxitur fëmijët e tyre të shkojnë në shkollë dhe shpërndarjen falas të teksteve shkollore në popullatat më të varfëra (konkretisht romë). ECRI vë në dukje se është njoftuar nga shumë burime që masat e marra aktualisht në kuadrin e kësaj strategjie mbeten, deri më sot, të rralla dhe se bashkësitë romë nuk janë afruar sa duhet në përpunimin dhe zbatimin e masave të nevojshme. Për më tepër, burime nga vetë shoqëria civile kanë theksuar se nuk mjafton thjesht shpërndarja falas e teksteve në familjet që s'kanë mjete për të dërguar fëmijët në shkollë, sepse vetë kostoja për pajisje të tjera shkollore mbetet pengesë. Ato theksojnë për domosdoshmërinë e ndërmarrjes së nismave të tilla që t'u bëhet ballë nevojave financiare të familjeve. Me sa duket, shumica e nismave të ndërmarra në fushën e edukimit të romëve janë hartuar nga organizata joqeveritare dhe financuar nga donatorë të jashtëm.

Rekomandime :

60. ECRI rekomandon të ndërmerren sa më shpejt nisma që synojnë rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve romë dhe egjiptianë në të gjitha nivelet e edukimit. Këto masa mund të jenë: dispozita financiare për t'u ardhur në ndihmë familjeve më të varfëra që të përballojnë shpenzimet e shkollimit; ndërgjegjësim i prindërve për rëndësinë e shkollimit të fëmijëve; marja në punë e romëve dhe egjiptianë si mësues dhe drejtor shkollash; formim i veçantë i arsimtarëve

për t'i bërë ata të ndjeshëm ndaj diskriminimit dhe nevojave të fëmijëve romë dhe egjiptianë ; dhënie sigurie që tekstet shkollore nuk nxisin stereotipe negative përsa i përket romëve dhe egjiptianëve, por përkundrazi, përmbajnë informacione për kulturën rome e egjiptiane dhe për kontributin pozitiv që japin këto bashkësi në shoqërinë shqiptare.

61. ECRI u rekomandon autoriteteve shqiptare të kenë parasysh që masat e përpunuara në kuadrin e « Strategjisë kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së romëve » të zbatohen në nivel vendor, me qëllim që të rritet pjesëmarrja e fëmijëve romë në të gjitha nivelet e edukimit. Ai u rekomandon organizatave dhe bashkësive rome në nivel lokal të marrin pjesë aktivisht në realizimin dhe zbatimin e masave që i përshtaten nevojave të bashkësisë së tyre. Përveç masave të lartpërmendura, do të ishte me vend të parashikohej, në rast nevojë, një formim paraprak dhe plotësues në gjuhën shqipe dhe mundësi mësimi të gjuhës romani. Po ashtu, ECRI u rekomandon fuqimisht autoriteteve të zgjidhin çdo problem regjistrimi dhe dokumentesh identifikimi që pengojnë fëmijët të shkollohen, dhe të bëjnë kështu të mundur që fëmijët të shkojnë në shkollë gjatë këtij procesi.
62. ECRI nxit autoritetet të mbështesin dhe të zgjerojnë nismat joqeveritare që kanë dhënë rezultate të mira, si krijimi i kopshteve për fëmijë, në të gjitha bashkësitë që kanë nevojë.
63. ECRI u rekomandon autoriteteve të kujdesen që të mos ketë diskriminim në shkollë ndaj fëmijëve romë dhe egjiptianë, konkretisht ai i caktimit të tyre në fund të klasës.

- **Mësimi në gjuhët minoritare**

64. Në raportin e tij të dytë, ECRI u rekomandonte autoriteteve të merrnin parasysh shqetësimet e shprehura nga përfaqësues të bashkësisë etnike maqedone përsa i përket mësimi të gjuhës së tyre amëtare në zona të ndryshme ku anëtarë të bashkësisë së tyre nuk njihen si të tillë.
65. ECRI vëren se përfaqësues maqedonë e grekë i kanë bërë të ditur shqetësimet e tyre lidhur me pamundësinë për anëtarë të bashkësive të tyre të marrin mësim në gjuhën e tyre amëtare në shkollë publike, për arsye se jetojnë jashtë zonave të klasifikuara më parë si « zona minoritetesh⁴ ». Në bazë të legjislacionit shqiptar, i takon një numri të caktuar prindërisht, të cilëve u njihet origjina etnike, për të bërë kërkesë që të ngrihet shkollë në gjuhën minoritare. Autoritetet shqiptare i kanë theksuar ECRI-t se konsultonin regjistrat e gjendjes civile për të përcaktuar origjinën etnike të njerëzve. Megjithatë, anëtarë të grupeve minoritare që jetojnë jashtë zonave të klasifikuara si « zona minoritare » hasin vështirësi për të regjistruar përkatësinë e tyre etnike në regjistrin e gjendjes civile⁵. Nga ana tjetër, përfaqësues të grupeve të tjera minoritare, si malazezët, arumun/vllehët dhe romët kanë deklaruar gjithashtu se dëshironin që fëmijët e tyre të kishin mësim në gjuhën e tyre amëtare.

⁴ "Zona minoritare" kanë ekzistuar para dhe pas regjimit të mwparswhm komunist dhe mbulonin zonat ku minoritetet kombëtare kanë jetuar tradicionalisht.

⁵ Shih më poshtë "Ndjekja e situatës".

Rekomandime :

66. ECRI u rekomandon autoriteteve shqiptare të konsiderojnë dhënien e mundësive për mësimdhënie në gjuhët e minoritetit.. ECRI i rekomandon gjithashtu autoriteteve shqiptare të kenë parasysh rrugën e nxitjes së kontakteve midis fëmijëve me origjinë etnike të ndryshme dhe të parashikojnë në këtë mënyrë modele të ndryshme mësimi në gjuhët minoritare, si shkolla ose klasa dygjuhëshe. ECRI u rekomandon nga ana tjetër autoriteteve shqiptare të pranojnë në këto programe fëmijë që nuk vijnë nga ndonjë grup minoritar ose që vijnë nga familje e përzier.

Media

67. Në raportin e tij të dytë për Shqipërinë, ECRI u rekomandonte mediave shqiptare të merrnin masa për të zhvilluar më tej klimën e përgjithshme të tolerancës e të mirëkuptimit midis anëtarëve të bashkësive të ndryshme etnike. Ai u rekomandonte konkretisht të miratonin një kod deontologjik për të luftuar kundër çdo paraqitjeje informacioni dhënë në mënyrë raciste, ksenofobe dhe diskriminuese, si dhe për të nxitur një paraqitje të paanshme e të baraspeshuar të fakteve.
68. ECRI nuk ka marrë asnjë informacion ku të thuhet se mediat shqiptare kanë përpunuar një kod deontologjik ose një metodë tjetër vetdisiplinimi lidhur me mënyrën si të paraqiten informacionet për grupet e ndryshme etnike ose për të ndëshkuar informacionet që nxisin diskriminimin, racizmin, tensionet etnike dhe armiqësinë. ECRI vëren se janë ndërmarrë nisma për t'u dhënë gazetarëve formim lidhur me mënyrën si të trajtohen çështjet që kanë të bëjnë me diversitetin.
69. Është vënë në dukje se mediat shqiptare shmangin çdo lloj informacioni që nxit racizmin dhe diskriminimin, ndonëse në disa raste vënë në veprim stereotipe negative lidhur me disa grupe minoritare, konkretisht romët. ECRI ka marrë po ashtu të dhëna se mediat shpesh nxisin ndjenja negative lidhur me minoritetet greke, maqedone e malazeze. Nga ana tjetër, mediat shqiptare nuk e mbulojnë aq sa duhet jetën e përditshme të anëtarëve të grupeve minoritare, problemet dhe shqetësimet e tyre. Më në fund, përfaqësues të grupeve të ndryshme minoritare e kanë vënë në dijeni ECRI-n se janë të shqetësuar nga fakti që nuk u jepeshin mjetet e duhura për t'u futur në shtypin e shkruar apo elektronik.

Rekomandime :

70. ECRI u rekomandon autoriteteve shqiptare të informojnë profesionistët e mediave për nevojën e miratimit të kodeve vetdisiplinuese për luftën kundër çdo dhënieje informacioni që do nxiste racizmin, diskriminimin dhe intolerancën, duke mbështetur në të kundërt një paraqitje të paanëshme dhe të ekuilibruar të fakteve, të cilat do të bënin të mundur zhvillimin e një klime të favorshme për diversitetin.
71. ECRI u rekomandon autoriteteve shqiptare të informojnë profesionistët e mediave për domosdoshmërinë e dhënies së informacione të nevojshme për

jetën e përditshme, problemet dhe shqetësimet e anëtarëve të bashkësive minoritare.

72. ECRI u rekomandon po ashtu të bëjnë gjithçka për t'u lejuar anëtarëve të grupeve minoritare të futen në shtypin e shkruar dhe elektronik.

Qëndrimi i përfaqësuesve të ligjit

73. Në raportin e tij të dytë për Shqipërinë, ECRI rekomandonte të ngarkohej një organizëm i pavarur për të hetuar të gjitha rastet e keqtrajtimit nga ana e punonjësve të policisë. Ai rekomandonte po ashtu të fuqizoheshin mekanizmat e kontrollit të brendshëm për raste deklarimesh të tilla. Më në fund, ECRI mbështeste autoritetet shqiptare për të vazhduar përpjekjet për t'u dhënë forcave të policisë formim lidhur me të drejtat e njeriut.
74. ECRI vëren me kënaqësi se autoritetet shqiptare kanë krijuar një Zyrë kontrolli të brendshëm ngarkuar për të luftuar korrupsionin dhe forma të tjera të fajeve profesionale. Megjithë përparimet e arritura, ECRI nuk ka marrë asnjë informacion për përmirësimin e sistemit të hetimeve të brendshme mbi keqtrajtimet nga ana e policisë. Sikurse del nga disa të dhëna, rrallë janë ndëshkuar policë për qëndrime të dënueshme. Përsa i përket përndjekjeve gjyqësore, procedurat kundër policëve të akuzuar për keqtrajtime, sipas disa vëzhgimeve, përgjithësisht ndërpriten para se të fillojë vetë procesi, dhe shpesh pa u bërë asnjë hetim paraprak i vërtetë. Nga ana tjetër, viktimat e keqtrajtimit ngurrojnë të ankohen, pikërisht sepse nuk kanë besim që ankesat e tyre do të merren parasysh.
75. ECRI vëren me kënaqësi se policisë në të gjitha nivelet i ajnë ofruar trajnime të të drejtave të njeriut. OJF-të kanë luajtur rol të rëndësishëm në këto nisma. Nga të dhënat e marra, del gjithashtu se, që prej raportit të dytë të ECRI-t, është ulur numri i çështjeve ku policia shpërdoron detyrën. Megjithatë, shpërdorimet dhe keqtrajtimet vazhdojnë të jenë probleme serioze.

Rekomandime :

76. ECRI u rekomandon autoriteteve shqiptare të kenë parasysh që rastet kur policia keqtrajton anëtarë të grupeve minoritare, të jenë objekt të një hetimi të thellë dhe autorët e shkeljeve t'i jepen drejtësisë. Ai rekomandon që procedura lidhur me hetimin e ankesave të ndiqet nga një organizëm i pavarur hetimi. Hetimi të ndiqet dhe mbikëqyret në tërë fazat e procedurës nga një organizëm i pavarur nga policia dhe Ministria e Rendit Publik.
77. ECRI thekson se rastet kur policia ushtron keqtrajtime që i paraqiten gjyqit, duhen trajtuar e përfunduar në mënyrën më të shpejtë të mundshme dhe autorët të ndëshkohen siç e meritojnë, me qëllim që shoqëria të kuptojë se të tilla qëndrime nga ana e policisë janë të patolerueshme dhe të ndëshkueshme.
78. ECRI u rekomandon autoriteteve shqiptare të përkujdesen që formimi me të drejtat e njeriut të jetë pjesë përbërëse e përgatitjes mësimore të policisë, në formimin fillestar dhe vazhduar, dhe të përfshihë të dhëna për racizmin dhe diskriminimin, si dhe për legjislacionin e zbatueshëm në këtë drejtim.

Monitorimi i situatës

79. Në raportin e tij të dytë, ECRI i fton drejtpërdrejt autoritetet shqiptare të përfshinin në regjistrimin e përgjithshëm një pyetje lidhur me përkatësinë etnike, duke respektuar parimin e identifikimit vetjak të vullnetshëm. Ai propozonte nga ana tjetër të përfshiheshin përfaqësues të grupeve etnike minoritare në etapat e ndryshme të këtij procesi.
80. Pyetjet lidhur me përkatësinë etnike, kombëtare e fetare nuk janë përfshirë në regjistrimin e vitit 2001. Autoritetet shqiptare kanë njoftuar ECRI-n se Instituti Kombëtar i Statistikave (*INSTAT*) ka bërë megjithatë një studim lidhur me gjendjen ekonomike, nivelin e jetesës dhe cakun e varfërisë së popullsisë, studim që përmbante edhe një çështje mbi përkatësinë kombëtare. ECRI vë në dukje se një studim i tillë nuk mund të zëvendësojë një regjistrim kombëtar, në të cilin do t'u lejohej gjithë shqiptarëve të deklaronin përkatësinë e tyre kombëtare, etnike e fetare. Përfaqësues të grupeve të ndryshme minoritare e kanë njoftuar ECRI-n se ishin të shqetësuar nga fakti që numri i tyre nënçmohej hapur prej autoriteteve shqiptare dhe se dëshironin më së miri të bëhej një regjistrim, i cili të pasqyronte, në mënyrën më të saktë, masën e tyre në përqindje, në raport me popullsinë shqiptare.
81. ECRI vë në dukje në këtë drejtim shqetësimin e shprehur nga bashkësitë greke e maqedone për faktin se ato janë njohur si minoritetet vetëm në zonat e klasifikuara si « zona minoriteti ». Ato kanë theksuar se jashtë këtyre zonave, ato nuk mund të regjistrojnë përkatësinë e tyre kombëtare në regjistrat e gjendjes civile, as të gëzonin, rrjedhimisht, të drejta të ndryshme që u jepen minoriteteve.

Rekomandime :

82. ECRI u rekomandon përsëri autoriteteve shqiptare të bëjnë një regjistrim kombëtar që të përmbajë një çështje lidhur me përkatësinë etnike, duke respektuar parimet e mirëbesimit dhe identifikimit vetjak të vullnetshëm. Në etapat e ndryshme të këtij procesi, duhen përfshirë përfaqësues të grupeve etnike minoritare.
83. Për më tepër, ECRI u rekomandon autoriteteve shqiptare të kenë parasysh që disa njerëz të mos e kenë të pamundur për të bërë të njohur zyrtarisht identitetin e tyre etnik, thjesht ngaqë nuk banojnë në zona tashmë të klasifikuara si zona minoritetesh.
84. Në raportin e tij të dytë, ECRI i nxiste autoritetet shqiptare të studionin mënyrën si mund të krijonin një sistem të plotë e koherent për mbledhjen e të dhënave që lejojnë vlerësimin e gjendjes së grupeve të ndryshme minoritare që jetojnë në Shqipëri dhe matjen e shkallës së shfaqjeve të racizmit e të diskriminimit.
85. ECRI nuk është në dijeni të kurrfarë përpjekjeje që mund të jetë bërë për mbledhjen e të dhënave që lejojnë të vlerësohet gjendja e minoriteteve etnike në fusha të ndryshme të jetës. ECRI vë në dukje se një mungesë e tillë të dhënash e bën të vështirë vlerësimin e shkallës së diskriminimit që ushtrohet në këto grupe si dhe rolin e masave të marra për përmirësimin e gjendjes.

Rekomandime :

86. ECRI u rekomandon përsëri autoriteteve shqiptare të krijojnë një sistem të tillë mbikëqyrjeje që të lejojë mbledhjen e të dhënave për gjendjen e bashkësive të ndryshme minoritare, matjen e shkallës e të shkaqeve të diskriminimit si dhe efektin e masave që duhen marrë për ta luftuar. Një sistem i tillë duhet të respektojë parimet e mirëbesimit dhe identifikimit vetjak të vullnetshëm të njerëzve që i përkasin një grupi të caktuar. Një kontroll i tillë duhet të ketë parasysh po ashtu kriterin e barazisë midis burrit e gruas, veçanërisht në këndvështrimin e një diskriminimi të mundshëm të dyfishtë a të shumëfishtë.

II. ÇËSHTJE TË VEÇANTA

Mënjanimi dhe pakujdesia ndaj romëve dhe egjiptianëve

87. ECRI është jashtëzakonisht i shqetësuar për kushtet jetësore të mjerueshme, për varfërinë e tejskajshme dhe mënjanimin shoqëror e ekonomik të mjaft romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri. Shumë prej tyre jetojnë në kasolle të rrënuara në zona pa shërbime themelore, ku përqindja e papunësisë është tepër e lartë dhe ku ka vështirësi të mëdha për t'i përfshirë në shërbime sociale, kryesisht shëndetësore. Vërehet nga ana tjetër një përqindje shumë e lartë braktisjeje e shkollës nga fëmijë të këtyre bashkësive, gjë që i bën ata të jenë në mënyrë të veçantë objekt trafiku i qenieve njerëzore⁶. Megjithëse këto probleme prekin gjithashtu grupe të tjera të popullsisë shqiptare, është e qartë se romët dhe egjiptianët vuajnë në mënyrë të tepruar nga këto kushte të mjerueshme. Përveç vështirësive dhe problemeve të karakterit të përgjithshëm që hasin të gjithë shqiptarët për shkak të ndryshimeve politike, shoqërore dhe ekonomike, vërehet se këto bashkësi u dashka të mbajnë mbi kurriz edhe një peshë tjetër, mënjanimin dhe mospërfilljen. Kjo gjendje bëhet edhe më e rëndë ngaqë ata nuk përfaqësohen dhe nuk marrin pjesë sa duhet në jetën publike, sikurse e theksojmë më poshtë⁷.
88. Në raportin e tij të dytë për Shqipërinë, ECRI u rekomandonte autoriteteve shqiptare të analizonin mënyrën se si grupe të pasigurta, sikurse romët dhe egjiptianët, mund të ishin objekt formash të ndryshme diskriminimi të tërthortë në fusha të ndryshme të jetës që kanë të bëjnë me funksionimin e shoqërisë dhe të institucioneve shqiptare, domethënë me korrupsionin rrethues apo mungesën e përfaqësimit të duhur në gjirin e institucioneve publike. Ai u rekomandonte gjithashtu të mos mbyllnin sytë para stereotipeve negative dhe paragjytimeve, që bëhen në disa raste burime diskriminimi. Më në fund, ai ishte i mendimit se ndoshta do të ishte e nevojshme të zbatoheshin masa të veçanta për të bërë të mundur që anëtarë të këtyre grupeve të prekshme të përfshiheshin po aq sa shqiptarët e tjerë në shërbimet publike dhe lehtësitë e domosdoshme.
89. ECRI nuk ka asnjë njoftim për realizimin, që prej raportit të tij të dytë, të një studimi nga ana e autoriteteve shqiptare për diskriminimin e tërthortë, as për efektin e stereotipeve negative në gjendjen e romëve dhe egjiptianëve. Përkundrazi, në shumë raste gjatë vizitës së ECRI-t, autoritetet shqiptare nuk

⁶ Shih më poshtë "Trafikimi i fëmijëve romë dhe egjiptianë".

⁷ Shih më poshtë "Pjesëmarrja e minoriteteve në jetën publike".

kanë munguar të kujtojnë se sipas legjislacionit shqiptar, të gjithë qytetarët janë të barabartë, dhe se romët e egjiptianët kishin kështu të njëjtat mundësi sikurse tërë qytetarët e tjerë në fushën e strehimit, edukimit, punësimit, shërbimeve sociale apo në çdo fushë tjetër të jetës. Për më tepër, është nxjerrë që këtej si konkluzion se një gjendje e tillë do të thoshte se nuk ekzistonte asnjë diskriminim në shoqërinë shqiptare. ECRI vëren megjithatë se nëse përpara ligjit anëtarët e grupeve minoritare gëzojnë të njëjtat të drejta sikurse qytetarët e tjerë, një gjë e tillë nuk garanton në praktikë një mungesë diskriminimi. ECRI thekson se për të zhdukur pabarazitë, anëtarët e grupeve minoritare duhet të gëzojnë trajtime të ndryshme, si masa konkrete që t'i përshtaten gjendjes së tyre të veçantë, duke patur nga ana tjetër kujdes që ligjet, politikat dhe praktikat, në dukje asnjënjëse, të mos kenë mbi ta një efekt negativ të pabarabartë.

90. ECRI vëren me kënaqësi në këtë drejtim se, përsa i përket romëve, autoritetet kanë përcaktuar një Strategji kombëtare « Për përmirësimin e kushteve të jetesës së Romavë », që synon të zhdukë të gjitha format e diskriminimit ndaj romëve dhe të nxisë këtë bashkësi të marrë pjesë aktivisht në jetën ekonomike, kulturore, sociale dhe politike të vendit. Autoritetet kanë njoftuar ECRI-n se një strategji e tillë synon të arrijë këto objektiva nëpërmjet veprimeve konkrete pozitive në fushat e edukimit, kulturës, mediave, shoqërisë civile, punësimit, strehimit, rendit publik, shëndetësisë, drejtësisë dhe ekonomisë. Megjithatë, sipas informatave që ka marrë, ECRI vëren se, gjatë procesit të përpunimit të strategjisë, ka të ngjarë që asnjë studim konkret të mos jetë realizuar në nivel lokal lidhur me problemet e veçanta që hasin bashkësitë e ndryshme rome. Burime nga shoqëria civile nuk kanë munguar përkundrazi të tërheqin vëmendjen e ECRI-t për faktin se zbatimi i strategjisë nuk gjeti përshtatje. Me sa duket, mungojnë mekanizmat e duhura për t'i kthyer masat që përmban strategjia në nisma lokale të veçanta dhe për të mbikëqyrur zbatimin e strategjisë. Një tjetër problem, që do të shqyrtohet më poshtë⁸, është pjesëmarrja e pamjaftueshme e romëve në zbatimin dhe kontrollin e strategjisë.

Rekomandime :

91. ECRI u rekomandon përsëri autoriteteve shqiptare të analizojnë mënyrën se si romët dhe egjiptianët mund të jenë objekt i formave të ndryshme të diskriminimit të tërthortë në fusha të ndryshme të jetës, dhe të vlerësojnë efektin e stereotipeve negative dhe të paragjykimeve që rëndojnë mbi këto grupe minoritare.
92. ECRI u rekomandon autoriteteve shqiptare të marrin masa për t'u kujdesur që bashkësitë rome dhe egjiptiane të mos jenë objekt diskriminimi nga indiferentizmi i disa drejtuesve dhe punonjësve të tjerë me funksione publike. ECRI kërkon nga këta të fundit, në nivel kombëtar e vendor, t'u kushtojnë vëmendjen e duhur problemeve dhe nevojave të veçanta të këtyre bashkësive në të gjitha fushat e jetës dhe t'u garantojnë integritet plotë në jetën ekonomike, sociale e politike. ECRI thekson se masa konkrete mund të jenë të nevojshme për t'u siguruar barazi faktike bashkësive rome dhe egjiptiane.
93. ECRI u rekomandon autoriteteve të vazhdojnë dhe të thellojnë përpjekjet për të zbatuar « Strategjinë kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së

⁸ Shih më poshtë "Pjesëmarrja e minoriteteve në jetën publike", "Zbatimi i Strategjisë kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së bashkësisë rome".

romëve » dhe të kujdesen në mënyrë të veçantë që strategjia të ndiqet dhe të zbatohet me efektshmëri në nivel vendor.

Pjesëmarrja e minoriteteve në jetën publike

- Pjesëmarrja në marrjen e vendimeve politike

94. ECRI është i shqetësuar për faktin se anëtarët e disa grupeve minoritare nuk marrin pjesë sa duhet në proceset vendimore të vendit në nivel kombëtar e lokal. Mungesa e statistikave e bën të pamundur vlerësimin e çështjes. Megjithatë, nga disa elementë të dhënash del se anëtarët e grupeve minoritare, konkretisht romët dhe egjiptianët janë jashtëzakonisht të nënpërfaqësuar në organet politike vendimmarrëse. Madje, edhe në bashkitë e zonat ku romët dhe egjiptianët përbëjnë një pjesë të madhe të popullsisë, shpesh ndodh që bashkësitë e tyre të mos jenë të përfaqësuara në këshillat bashkiake, ose të jenë në mënyrë tepër të kufizuar. ECRI druhet konkretisht se mos një gjendje e tillë çon në mënjanimin e këtyre bashkësive dhe në njëfarë indiferentizmi ndaj tyre, dukuri që shprehen me shkallën e ulët të vëmendjes dhe të burimeve kushtuar zonave me ngulime rome e egjiptiane dhe mbrojtjes së interesave të tyre.
95. Kjo gjendje duket e rënduar nga pjesëmarrja përgjithësisht e dobët e romëve dhe egjiptianëve në procesin politik, si përfaqësues të partive politike dhe si zgjedhës. Sipas vëzhgimeve të bëra pas zgjedhjeve të fundit vendore, përqindja e pjesëmarrjes së zgjedhësve të regjistruar që u përkasin grupeve minoritare ishte shumë e dobët, kryesisht për romët dhe egjiptianët. Nga ana tjetër, mjaft romë e egjiptianë nuk janë regjistruar në listat elektorale. Kjo pjesëmarrje e dobët ka të ngjarë të jetë e lidhur të paktën pjesërisht me njëfarë mungese besimi te partitë politike dhe me ndjenjën që këto parti nuk përfaqësojnë interesat e bashkësive të tyre. Nga ana tjetër, ECRI ka marrë të dhëna nga zona të ndryshme të vendit që tregojnë se kandidatët për zgjedhje shfrytëzojnë varfërinë, kushtet e vështira të jetesës dhe nivelin e dobët arsimor të mjaft romëve dhe egjiptianëve duke blerë votat e tyre apo duke u bërë premtime para zgjedhjeve, për t'i harruar njëherë e mirë me të mbërritur në pushtet.

Rekomandime :

96. ECRI u rekomandon autoriteteve shqiptare të marrin masa për t'u kujdesur që grupet minoritare, konkretisht romët dhe egjiptianët, të përfaqësohen efektivisht në gjirin e organeve politike në rrafsh kombëtar e vendor.
97. ECRI rekomandon të ndërmerren nisma për të rritur pjesëmarrjen e romëve dhe egjiptianëve në proceset politike, duke kryer konkretisht studime lidhur me shkaqet për të cilat një numër i madh egjiptianësh e romësh nuk janë regjistruar në listat elektorale, dhe duke marrë masa për të përballuar këto probleme.

- Përfaqësimi në institucionet publike

98. Në raportin e tij të dytë, ECRI vinte në dukje shqetësimin e grupeve minoritare lidhur me nënpërfaqësimin e tyre në institucionet shtetërore, kryesisht në shërbimet publike, polici dhe forcat e armatosura, dhe u kërkonte autoriteteve shqiptare të parashikonin masa për ndjekje dhe shëndoshje të gjendjes.

99. Nuk disponohet asnjë informacion për të krijuar një ide të saktë lidhur me përfaqësimin e anëtarëve të grupeve minoritare në organizma të ndryshme publike. Po ashtu, që prej raportit të tij të dytë, ECRI nuk ka marrë ndonjë të dhënë që të flasë për rritje të përfaqësimit të tyre në institucionet shtetërore. Nga ana tjetër, sipas informacioneve të dhëna nga përfaqësues të grupeve minoritare, kjo gjendje vazhdon të shtrojë probleme për grupet e ndryshme minoritare të vendit. Numri i egjyptianëve dhe romëve në institucionet publike duket veçanërisht i dobët, dhe personat e rallë që punojnë në sektorin publik ushtrojnë në shumicën e tyre funksione pastrimi apo mirëmbajtjeje. ECRI-t i tërhoqi vëmendjen fakti që kjo gjendje nuk mund të shpjegohet thjesht me nivelin arsimor, kur ndërkohë, bashkësitë rome dhe egjyptiane kanë njerëz të kualifikuar dhe të arsimuar. Përfaqësues grekë kanë theksuar se bashkësia e tyre ishte e përfaqësuar në polici dhe gjykatë, por vetëm në lokalitetet e Gjirokastrës dhe Sarandës.
100. Autoritetet shqiptare e kanë njoftuar ECRI-n se nuk kishte asnjë pengesë zyrtare për pjesëmarrjen e anëtarëve të grupeve minoritare në institucionet shtetërore. Megjithatë, nuk është ndërmarrë kurrfarë nisme e veçantë për të rritur përfaqësimin e minoriteteve në shërbimet publike, forcat e armatosura ose në sistemin gjyqësor. Përsa i përket policisë, autoritetet shqiptare i kanë theksuar ECRI-t se një grup pune, i ngarkuar për të rishikuar legjislacionin në këtë fushë, ka rekomanduar rishikimin e ligjit, me qëllim që të nxitet një pjesëmarrje më e madhe e anëtarëve të grupeve minoritare në organizmat e ruajtjes së rendit në zonat ku ata jetojnë në numër të madh. Një nga amendamentet që duhet patur parasysh do bënte të mundur vendosjen e kuotave në pjesëmarrjen e anëtarëve të grupeve minoritare në gjirin e institucioneve publike në këto zona.

Rekomandime :

101. ECRI u rekomandon autoriteteve shqiptare të marrin masa për të rritur përfaqësimin e anëtarëve të grupeve të ndryshme minoritare të vendit në institucionet e shtetit, konkretisht në shërbimet publike, forcat e armatosura, sistemin gjyqësor dhe polici, si në nivel kombëtar, ashtu dhe vendor. ECRI i nxit gjithashtu të kenë parasysh që nisma të tilla të mos mbeten të kufizuara vetëm në zonat e klasifikuara më parë si zona minoritare

- Konsultimi dhe pjesëmarrja e anëtarëve të grupeve minoritare

102. Anëtarët e grupeve minoritare marrin pjesë më pak në vendimmarrje, për shkak të mungesës së mekanizmave për konsultim në nivel kombëtar e lokal, edhe kur është fjala drejtpërdrejt për interesat e minoriteteve. Ky problem ka lidhje me nocionin e kufizuar të marrjes së mendimit që, me sa duket, mbisundon në qarqet zyrtare dhe sipas të cilit mjafton një përfaqësues ose një organizatë e vetme për të përfaqësuar nevojat dhe interesat e një grupi të caktuar minoritar. Si rregull i përgjithshëm, drejtuesit publikë të ngarkuar për përpunimin ose zbatimin e politikave nuk e gjykojnë pra të dobishme të marrin masa për të konsultuar elementët e ndryshëm brenda një grupi minoritar të caktuar, përfshirë edhe grupet më të mënjanuara, nevojat dhe interesat e të cilave shpesh nuk « përfaqësohen » nga elitat sunduese. Për shembull, ECRI është informuar nga drejtues të ndryshëm se grupet minoritare do të përfaqësohen këtej e tutje nga një përfaqësues që do ketë origjinën e tyre dhe do marrë pjesë në Komitetin kombëtar të posaçëm për minoritetet. ECRI vë në dukje se grupet minoritare nuk

kanë interesa të njëllojta dhe se konsultimi duhet të bëhet duke dëgjuar zëra të ndryshëm brenda grupeve minoritare.

103. ECRI nënvizon në këtë drejtim se është e rëndësishme që anëtarët e grupeve minoritare të paraqesin sa më mirë nevojat e tyre dhe të marrin pjesë aktivisht në marrjen e vendimit politik. Me sa duket, ekziston në Shqipëri një nevojë reale për të ndihmuar anëtarët e grupeve minoritare, e në veçanti romët dhe egjiptianët më të marginalizuar, për të zhvilluar njohuritë, kompetencat dhe strukturat e nevojshme, me qëllim që ata të arrijnë të marrin pjesë aktivisht në vendimet publike. Informacionet që ka marrë ECRI tregojnë megjithatë një prirje të kundërt, për shembull nismat e ndërmarra për të ndihmuar bashkësitë rome pa pjesëmarrje të tyre në përpunimin, zbatimin dhe vlerësimin e këtyre masave. Rrjedhimisht, vetë këto masa shpesh nuk u përgjigjen si duhet nevojave të anëtarëve të këtyre bashkësive, dhe në këtë mënyrë i përjashtojnë ata edhe më shumë nga jeta publike, në vend që të ndihmojnë për integrimin e tyre politik e shoqëror.

Rekomandime :

104. ECRI rekomandon krijimin e mekanizmave zyrtarë dhe jozyrtarë për të bërë të mundur që elementët dhe interesat e ndryshëm të grupeve minoritare të konsultohen dhe të marrin pjesë në vendimmarrje në rrafsh kombëtar dhe vendor.
105. ECRI u rekomandon fuqimisht drejtuesve publikë shqiptarë të mos kufizohen vetëm tek një përfaqësues ose një numër i kufizuar përfaqësuesish që bëjnë pjesë në organizma publikë ose që kanë funksione në rrafsh kombëtar, për të shprehur interesat e grupeve të ndryshme minoritare, por të kërkojnë gjithashtu zëra të tjerë në nivelin më të afërt të popullsisë, konkretisht midis njerëzve drejtpërdrejt të interesuar për një numër masash e vendimesh.
106. ECRI u rekomandon autoriteteve shqiptare të nxisin dhe të mbështesin nisma edukimi dhe formimi për të bërë më shumë të mundur që romët dhe egjiptianët të marrin pjesë aktivisht në marrjen e vendimit politik. Në mënyrë të veçantë, do të ishte me vend formimi me edukatë qytetare dhe rritja e aftësive vepruese të organizatave aktive të shoqërisë civile në terren.
107. ECRI u rekomandon autoriteteve shqiptare të nxisin e të përkrahin pjesëmarrjen në rrafsh lokal të bashkësive minoritare dhe të organizatave aktive në përpunimin, zbatimin dhe përfundimin e projekteve dhe masave për të cilat ato janë drejtpërdrejt të interesuara.

- Zbatimi i Strategjisë kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së romëve

108. ECRI është jashtëzakonisht i shqetësuar për faktin se nuk është krijuar asnjë mekanizëm në rrafsh kombëtar ose vendor për të siguruar një pjesëmarrje të vërtetë të romëve në zbatimin dhe vlerësimin e Strategjisë kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së romëve. Ai nuk ka marrë asnjë të dhënë ku të tregohen qartë mënyrat zbatuese të strategjisë në rrafsh vendor dhe rolet që duhet të luajnë anëtarët e bashkësive rome dhe organizatat rome që punojnë në nivel të popullsisë lokale për zbatimin dhe vlerësimin e kësaj strategjie. Përkundrazi, ECRI ka marrë nga ana e organizatave dhe e përfaqësuesve të

romëve shumë të dhëna që tregojnë se strategjia është duke u zbatuar me pjesëmarrje të kufizuar të romëve në përpunimin e masave të veçanta, në realizimin dhe vlerësimin e tyre.

109. Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale, që është ngarkuar të vlerësojë zbatimin e strategjisë, i ka theksuar ECRI-t se ishte krijuar një rrjet me drejtues të shoqatave romë, që do marrin pjesë në këtë kontroll, me qëllim që të sigurohet një baraspeshë midis institucioneve qendrore dhe shoqatave. ECRI megjithatë vë në dukje se roli që do luajë ky rrjet në vlerësimin e strategjisë nuk shfaqet i qartë. Veç kësaj, nuk përcaktohet sa herë do mbledhet ky rrjet dhe nuk dihet nëse lista e anëtarëve të tij shtrihet në rrafsh lokal dhe përfshin bashkësitë e ndryshme romë që duhet të jenë në qendër të vëmendjes të vetë strategjisë. ECRI nuk ka marrë të dhëna të tjera që të tregojnë mënyrën se si romët do të përfshihen në zbatimin dhe kurorëzimin e strategjisë.

Rekomandime :

110. ECRI u rekomandon autoriteteve shqiptare të përkujdesen që romët të marrin pjesë rregullisht, në të gjitha drejtimet, gjatë zbatimit dhe vlerësimit të Strategjisë kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së romëve në rrafsh kombëtar e lokal. Ai u kërkon të bëjnë të mundur që të përfshihen në të anëtarë të bashkësive romë të interesuar drejtpërdrejt për strategjinë, si dhe organizata të ndryshme romë që veprojnë në nivel vendor.

Trafiku i fëmijëve romë dhe egjiptianë

111. ECRI është jashtëzakonisht i preokupuar nga fenomeni relativisht i përhapur i trafikut të fëmijëve shqiptarë për qëllime shfrytëzimi. Në mënyrë të veçantë, ECRI është i shqetësuar për faktin se një numër disproporcional fëmijësh romë dhe egjiptianë janë viktime të kësaj dukurie. Në fakt, sipas burimeve qeveritare dhe joqeveritare, shumica e fëmijëve viktime të trafikut janë nga bashkësitë romë dhe egjiptiane.
112. Fëmijët përgjithësisht dërgohen në vendet fqinje, kryesisht në Greqi e Itali. Disa janë viktime të trafikut edhe në Shqipëri, duke qenë se këta fëmijë tërhiqen nga zonat fshatare drejt qendrave të mëdha, si Tirana dhe Durrësi. Si rregull i përgjithshëm, fëmijët viktime të trafikut kryesisht shfrytëzohen si krahë pune : ata për shembull janë të detyruar të lypin apo të shesin sende të vogla në rrugë, apo të lajnë xhamat e makinave. Shpesh përdoren për veprimtari të paligjshme, konkretisht për shitje të drogës apo vjedhje të organizuar. Të tjerë, sidomos adoleshentë, shfrytëzohen edhe për qëllime prostitucioni. Fëmijët më të prekshëm vijnë nga familje të rrënuara, që jetojnë në varfëri të madhe dhe kanë një përqindje të lartë analfabetizmi. Në mjaft raste, trafikanti është një i afërt apo një i njohur, por familjet nuk janë në dijeni të gjendjes në të cilën ndodhen fëmijët e tyre kur këta janë në duart e trafikantëve. Sot, shumë fëmijë janë zhdukur dhe nuk dihet ku ndodhen. ECRI vëren se një numër i konsiderueshëm fëmijësh romë dhe egjiptianë, që bëhen viktime të këtij fenomeni, pasqyrojnë marginalizimin dhe indiferentizmin e veçantë, objekt i të cilave janë grupet minoritare në gjirin e shoqërisë shqiptare⁹.

⁹ Shih më sipër "Mënjanimi dhe pakujdesi ndaj romëve dhe egjiptianëve".

113. ECRI vëren me kënaqësi se autoritetet shqiptare e kanë njohur kohët e fundit këtë problem dhe se një grup ndërministerior ka përpunuar një strategji kombëtare për luftën kundër trafikut të qenieve njerëzore. Në kuadrin e kësaj strategjie, u krijua për këtë qëllim një njësi e veçantë policie. Sipas të dhënave të disponueshme, kjo njësi është përdorur për të ndjekur e luftuar rrjetet e trafikantëve. Strategjia kombëtare përmban gjithashtu masa të tjera të ndryshme, si reintegrimin e fëmijëve. Autoritetet shqiptare e kanë vënë në dijeni ECRI-n se një strategji e veçantë që synon të luftojë trafikun e fëmijëve romë është në zhvillim e sipër. Megjithatë, sipas burimeve nga shoqëria civile, pavarësisht nga vullneti i mirë i autoriteteve qendrore, do duhen ndërmarrë edhe më shumë nisma për të arritur : në ndërgjegjësimin e tërë shoqërisë dhe në mënyrë të veçantë të popullsisë të prekshme lidhur me trafikun e qenieve njerëzore ; në parandalimin e tij ; në ndihmën e efektshme që u duhet dhënë fëmijëve viktimë të trafikut ; në mbrojtjen dhe përkujdesin që duhet treguar pas kthimit të tyre ; në ripërfshirjen e tyre në shoqëri. Nga ana tjetër, me sa duket, zbatimi i strategjisë kombëtare paraqet vështirësi të mëdha në nivel lokal, duke qenë se përgjegjësit më kryesorë në nivel lokal, konkretisht personat e ngarkuar me asistencën sociale, nuk i dinë detyrat e tyre në kuadrin e strategjisë dhe nuk e njohin sa duhet problemin.
114. ECRI është i shqetësuar nga disa të dhëna sipas të cilave bashkësitë rome dhe egjiptiane, ndonëse janë prekur nga trafiku i qenieve njerëzore në mënyrë të konsiderueshme, nuk janë konsultuar apo përfshirë sa duhet në përpunimin dhe zbatimin e masave. ECRI thekson se, për të parandaluar me efektshmëri trafikun e fëmijëve romë dhe egjiptianë, autoritetet shqiptare duhet të punojnë me këto bashkësi për të përpunuar masa të tilla të efektshme që të zhdukin përqindjen e lartë të varfërisë, analfabetizimit dhe braktisjes së shkollës brenda këtyre bashkësive, si dhe mungesën e rrethanave favorizuese dhe marginalizimin që tregohet ndaj tyre.

Rekomandime :

115. ECRI u rekomandon autoriteteve shqiptare të vazhdojnë e të thellojnë përpjekjet për të luftuar kundër trafikut të fëmijëve. Këtyre përpjekjeve u duhet kushtuar vëmendja e duhur dhe burime të mjaftueshme, me qëllim që të arrihet në ndërgjegjësimin, parandalimin, kthimin e fëmijëve të zhdukur, mbrojtjen dhe përkujdesin ndaj viktimave pas kthimit, si dhe në reintegrimin e tyre.
116. ECRI rekomandon fuqimisht të përfshihen drejtpërdrejt përfaqësuesit e bashkësive egjiptiane dhe rome në përpunimin dhe zbatimin e masave që synojnë të luftojnë trafikun e fëmijëve të tyre.
117. ECRI u rekomandon autoriteteve shqiptare të bashkëpunojnë me komunitetet egjiptiane dhe rome për të përcaktuar nisma të efektshme ndërgjegjësimi, me qëllim që këto bashkësi të njihen nga afër me fenomenin dhe për të përpunuar masa parandaluese rezultative për t'u bërë ballë problemeve bazë, si: varfërisë, mungesës së rrethanave ekonomike favorizuese dhe nivelit të dobët të arsimit.
118. ECRI thekson se autoritetet shqiptare duhet të marrin me shpejtësi masat e domosdoshme për të siguruar që Strategjia kombëtare e luftës kundër trafikimit të zbatohet në mënyrë të efektshme në rrafsh lokal. Në këtë drejtim, ECRI nxit autoritetet shqiptare të bëjnë të mundur që personat përgjegjës publikë nëpër rrethe të njohin detyrat e tyre në këtë fushë, të kenë burime të mjaftueshme për t'i realizuar si duhet dhe të marrin formimin e nevojshëm për të qenë të përgatitur

në këtë drejtim. Më në fund, ECRI e sheh të dobishme të krijohet një mekanizëm koordinimi e kontrolli për veprimtaritë që do ndërmarrin përgjegjësit e rrethve lidhur me zbatimin e strategjisë kombëtare.

Diskriminim bazuar mbi identitetin egjiptian

119. Në raportin e tij të dytë për Shqipërinë, ECRI i nxiste autoritetet shqiptare të mbanin parasysh problemin e veçantë që shtronin drejtuesit e bashkësisë egjiptiane, domethënë mosnjohjen e identitetit të tyre.
120. Autoritetet shqiptare i kanë theksuar ECRI-t se ato e kishin studjuar këtë çështje dhe se nuk i njihnin egjiptianët si minoritet. Përfaqësues egjiptianë e kanë vënë ECRI-n në dijeni të shqetësimit të tyre të vazhdueshëm lidhur me këtë çështje. ECRI vëren se faktikisht egjiptianët shihen si minoritet i veçantë në shoqërinë shqiptare nga ana e publikut, mediave dhe disa drejtuesve shqiptarë, të cilët i shohin egjiptianët si grup më vete, duke i përcaktuar shpesh me emërtime të veçanta. Në këtë drejtim, ECRI druhet se mos termat e veçanta me të cilat përcaktohen egjiptianët në shoqërinë shqiptare përmbajnë kuptime përçmuese dhe bëjnë thjesht aluzion për ngjyrën e lëkurës.
121. ECRI është shumë i shqetësuar nga fakti se një gjendje e tillë ka çuar në diskriminimin e egjiptianëve në raport me minoritetet e tjera në Shqipëri, lidhur me mundësinë e tyre për të tërhequr vëmendjen e autoriteteve në problemet dhe shqetësimet e veçanta. Egjiptianët përballen kështu me njëfarë marginalizimi në jetën publike dhe me një indiferentizëm të përgjithshëm nga ana e autoriteteve shqiptare kur bëhet fjalë për problemet dhe nevojat e tyre të veçanta. Me sa duket, ata nuk mbahen parasysh në përpunimin e politikave që prekin fusha të ndryshme të jetës. Kjo do të thotë se asnjë masë nuk është marrë për të përcaktuar nëse bashkësitë egjiptiane diskriminohen drejtpërdrejt apo tërthorazi në fusha të ndryshme të jetës apo nëse janë viktime të racizmit në shoqëri. Rrjedhimisht, nuk është bërë e mundur të përcaktohen masa konkrete për t'u orvatur drejt zgjidhjes së këtyre problemeve.
122. Nga ana tjetër, egjiptianët me sa duket përjashtohen nga strukturat publike të krijuara posaçërisht për t'iu përgjigjur nevojave të minoriteteve në vend. Për shembull, Komiteti kombëtar i posaçëm për minoritetet, që është ngarkuar t'i paraqesë rekomandime qeverisë për çështjet e minoriteteve, nuk ka në gjirin e tij asnjë përfaqësues nga minoriteti egjiptian¹⁰. Komiteti i shpjegoi ECRI-t se kjo gjendje rezultonte për faktin që ky minoritet nuk njihet juridikisht në vend dhe rrjedhimisht nuk mund të përfaqësohet në Komitet. Po ashtu, Zyra e minoriteteve kombëtare e ka informuar ECRI-n se nuk mblidhet me egjiptianët dhe se nuk merret me problemet e tyre, duke qenë se nuk përbëjnë një minoritet juridikisht të njohur.

¹⁰ Shih më sipër pjesët “Organet e specializuara dhe institucionet e tjera” dhe “Komiteti kombëtar i posaçëm për minoritetet”.

Rekomandime :

123. ECRI u kërkon autoriteteve shqiptare të bëjnë të mundur që parimi i mosdiskriminimit të zbatohet plotësisht ndaj egjyptianëve në Shqipëri.
124. ECRI u rekomandon autoriteteve shqiptare të përkujdesen që egjyptianët të mos jenë viktima të diskriminimit lidhur me pjesëmarrjen dhe përfshirjen e tyre në institucionet publike të ngarkuara për t'iu përgjigjur nevojave dhe preokupimeve të minoriteteve në Shqipëri. ECRI rekomandon konkretisht që egjyptianët të përfaqësohen në Komitetin kombëtar të posaçëm për minoritetet dhe të merren në konsideratë nga Zyra e minoriteteve kombëtare.
125. ECRI u rekomandon autoriteteve shqiptare t'i kushtojnë vëmendje të veçantë problemeve që hasin bashkësitë egjyptiane dhe të marrin në bashkëpunim me to masa të efektshme për nevojat e tyre të veçanta, konkretisht masa për luftën kundër çdo forme diskriminimi të tërthortë apo racizmi, që drejtohet ndaj tyre. Autoritetet shqiptare mund të parashikojnë miratimin e një Strategjie kombëtare të posaçme për përmirësimin e gjendjes së egjyptianëve në Shqipëri.

BIBLIOGRAFI

Në këtë bibliografi paraqitet lista e burimeve kryesore të informacioneve publike që janë përdorur gjatë shqyrtimit të gjendjes në Shqipëri : nuk duhet konsideruar si një listë e plotë për krejt burimet e të dhënave vënë në dispozicion të ECRI-t gjatë përgatitjes së raportit.

1. CRI (2001) 2: *Second Report on Albania*, European Commission against Racism and Intolerance, Council of Europe, 3 April 2001
2. CRI (99) 48: *Report on Albania*, European Commission against Racism and Intolerance, Council of Europe, 9 November 1999
3. CRI (96) 43: *ECRI General Policy Recommendation n° 1: Combating racism, xenophobia, antisemitism and intolerance*, European Commission against Racism and Intolerance, Council of Europe, October 1996
4. CRI (97) 36: *ECRI General Policy Recommendation n° 2: Specialised bodies to combat racism, xenophobia, antisemitism and intolerance at national level*, European Commission against Racism and Intolerance, Council of Europe, June 1997
5. CRI (98) 29: *ECRI General Policy Recommendation n° 3: Combating racism and intolerance against Roma/Gypsies*, European Commission against Racism and Intolerance, Council of Europe, March 1998
6. CRI (98) 30: *ECRI General Policy Recommendation n° 4: National surveys on the experience and perception of discrimination and racism from the point of view of potential victims*, European Commission against Racism and Intolerance, Council of Europe, March 1998
7. CRI (2000) 21: *ECRI General Policy Recommendation n° 5: Combating intolerance and discrimination against Muslims*, European Commission against Racism and Intolerance, Council of Europe, April 2000
8. CRI (2001) 1: *ECRI General Policy Recommendation N° 6: Combating the dissemination of racist, xenophobic and antisemitic material via the Internet*, European Commission against Racism and Intolerance, Council of Europe, December 2000
9. CRI (2003) 8: *ECRI General Policy Recommendation N°7: National legislation to combat racism and racial discrimination*, European Commission against Racism and Intolerance, Council of Europe, December 2002
10. CRI (2004) 26: *ECRI General Policy Recommendation N° 8: Combating racism while fighting terrorism*, European Commission against Racism and Intolerance, Council of Europe, March 2004
11. CRI (2004) 37: *ECRI General Policy Recommendation N°9: The fight against antisemitism*, European Commission against Racism and Intolerance, Council of Europe, June 2004
12. CRI (98) 80 rev: *Legal measures to combat racism and intolerance in the member States of the Council of Europe*, European Commission against Racism and Intolerance, Council of Europe, 2000
13. Criminal Code of Albania
14. Republic of Albania Law No. 9098 on *The Integration and Family Reunion of Foreigners Granted Asylum in the Republic of Albania*, 03/07/2003
15. Parliamentary Assembly of the Council of Europe: Doc 10116, *Honouring of Obligations and Commitments by Albania*, Committee on the Honouring of Obligations and Commitments by Member States of the Council of Europe, 23 March 2004
16. ACFC/INF/OP/I(2003)004: Advisory Committee on the Framework Convention for the Protection of National Minorities, *Opinion on Albania*, 12 September 2002

17. SP/NDR (2003) 003: Secretariat of the Framework Convention for the Protection of National Minorities, *Non discrimination review under the Stability Pact for South Eastern Europe: Albania - Final report*, December 2003
18. CPT/Inf (2003) 11: Comité européen pour la prévention de la torture et des peines ou traitements inhumains ou dégradants (CPT), *Rapport au Gouvernement de l'Albanie relatif à la visite effectuée en Albanie par le Comité européen pour la prévention de la torture et des peines ou traitements inhumains ou dégradants* du 22 au 26 octobre 2001, 22 Janvier 2003
19. CERD/C/63:CO/1: United Nations Committee on the Elimination of Racial Discrimination, *Concluding observations of the Committee on the Elimination of Racial Discrimination: Albania*, 10 December 2003
20. CERD/C/SR.1528 : United Nations Committee on the Elimination of Racial Discrimination, Sixty-third session, *Summary record of the 1585th meeting, Consideration of Reports, Comments and Information submitted by States Parties under Article 9 of the Convention (continued)*, 11 August 2003
21. CERD/C/397/Add.1: United Nations Committee on the Elimination of Racial Discrimination, *Reports submitted by States Parties under Article 9 of the convention, Fourth Periodic Reports of States parties due in 2001: Albania*, 12 March 2003
22. OSCE, UNHCR, DfR, IOM, *Annual Pre-Screening Report 2003*, Tirana April 2004.
23. ODHIR.GAL/12/04: OSCE Office for Democratic institutions and Human Rights, *Election observation mission report, local governmental elections 12 October 2003 – 25 January 2004*, OSCE-ODIHR, 26 February 2004
24. Albanian Helsinki Committee, *Minorities in Albania*, Tirana 2003
25. Albanian Helsinki Committee, *Progress report on the implementation of the project « the diversity and coexistence of the minorities – an important factor for the stability in the region »*, July-December 2002
26. Albanian Helsinki Committee, *Situation in Albania 2002*
27. American Bar Association, *Central and East European Law Initiative, Judicial Reform Index for Albania*, December 2001
28. Amnesty International, *Annual Report January-December 2003: Albania*
29. Commission of the European Union, *Stabilisation and Association Report 2004, Albania*, Commission staff working paper
30. Human Rights Watch, *World Report 2003: Albania*, 26 January 2004
31. INSTAT Quarterly Statistical Bulletin Number 3, *Informations, analyses and periodical statistical data, 2003*
32. International Crisis Group, Balkans report n°140, *Albania: State of the Nation 2003*, 11 March 2003
33. International Helsinki Federation for Human Rights, *Annual Report 2003 – Albania*
34. International Organisation for Migration (IOM), *Analysis of Albanian immigration and practice as compared to EU and international standards*, Tirana, 1 January 2000
35. Southeast European Times in Albania, Ardi Pulaj, April 6 2004.
36. Terre des hommes, *The Trafficking of Albanian Children in Greece*, January 2003.
37. U.S. Department of State, *Country Reports on Human Rights Practices – 2003: Albania*, 25 February 2004
38. US Department of State, *Country Reports on Human Rights Practices - 2002: Albania*, 31 March 2003

